



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1288/prot.

Pogradec, më 11, 03, 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

"PER MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA, PËR VENDOSJEN ANTENE TË TELEFONISË TË LËVIZSHME NË FAVOR TE KOMPANIVE ONE ALBANIA SH.A NË SIPËRFAQE, 160 M2 NE PASURINE 665 ZK 2042 KALIVAÇ, TREBINJE DHE DHE VODAFON ALBANIA SH.A SIPERFAQEN 100 M2 NE PASURINE 213/6 ZK 3753 VËRRI PROPTISHT"

Me respekt,



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 22 (Njzet e dy)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____, ____ 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, DATË ____/____/2026

PER MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA, PËR VENDOSJEN ANTENE TË TELEFONISË TË LËVIZSHME NË FAVOR TE KOMPANIVE ONE ALBANIA SH.A NË SIPËRFAQE, 160 M2 NE PASURINE 665 ZK 2042 KALIVAÇ, TREBINJE DHE DHE VODAFON ALBANIA SH.A SIPERFAQEN 100 M2 NE PASURINE 213/6 ZK 3753 VËRRI PROPTISHT.

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtarive ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie me qira, për vendosje antene të telefonisë së levizeshme, në favor të kompanive One Albania Sh.a në sipërfaqe, 160 m2 në pasurine 665 zk 2042 Kalivaç, Trebinje dhe dhe Vodafon Albania Sh.a sipërfaqen 100 m2 në pasurine 213/6 zk 3753 Vërrit Proptisht,
2. Afati i dhenies me qira të jete deri në 10 vite, me të drejtë ripertëritje, sipas periudhes të percaktuar në projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit..
3. Në referim të bazës ligjore të sipercituar, ky proces të kryhet sipas percaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të

kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022. Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "

4. Tarifat për dhënien me qera të kesaj pasuri, të aplikohen sipas pikes "7", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
5. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Pogradec për ndjekjen e procedurave ligjore dhe për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

RELACION

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA, PËR VENDOSJEN ANTENE TË TELEFONISË TË LËVIZSHME NË FAVOR TE KOMPANIVE ONE ALBANIA NË SIPËRFAQE, 160 M2 NE PASURINE 665 ZK 2042 KALIVAÇ, TREBINJE DHE DHE VODAFON ALBANIA SIPERFAQEN 100 M2 NE PASURINE 213/6 ZK 3753 VËRRI PROPTISHT.

I NDERUAR KRYETARE KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, referuar pikës 2 të nenit 27 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ndër të cilat është edhe Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme, pyll,etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posacerisht të kaluara në pronësi të saj me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive",

Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin.

Për sa më sipër, Sektori i Trajtimit të Titujve të Pronësisë dhe Shpronësimeve, Bashkia Pogradec, ka marrë evidentuar pronen me nr 665 Zk 2042 dhe pronen me numur 213/6 Zk 3753 qe mund te jete nje prone qe mund te perdoren per vendosjen e antenave te telefonise se levizeshme, për vete pozicionimin dhe vendosjen e ketyre pronave mbasi eshte larg nga qendrat e banuar dhe pa ndikime ne mjedis.

Nga analiza dhe interesimi e dy kompanive dhe pozicionin e pasurise propozojme dhenien me qera te siperfaqes prej 160 m2 ne kordinatat X-466765 dhe Y-4523925 te kerkuar nga kompania One Albania sh.a pasuria 665 Zk 2042 Fshati Kalvaç Njesia Administrative Trebinjë, si dhe siperfaqen prej 100 metra katror ne kordinatat X-458041.72 dhe Y-4539539.91 te kerkuar nga kompania Vodafone Albania sh.a pauria 213/6 Zona kadastrale 3753 fshati Verri Njesia Administrative Proptisht siperfaqe te cilat sipas llojit te qeverisjes se pyjeve sipas planit te mbareshtimit te ish komunes Cerrave eshte pyll .

Sipas VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive",, pasurite 665 Zona kadastrale 2042 dhe 213/6 Zonakadastrale 3753 i kalon ne pronesi Bashkise Pogradec., e cila ka dokumentacionin perkates te pronesise, bashkangjitur ketij relacioni sipas VKM perkatese dhe i korespondon ngastrave pyjore 41 ekonomia pyjore Moker 1 dhe ngastra nr 5 ekonomia kullosore Vërri- Debrovë.

¹Bolevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Siperfaqet e kerkuara ndodhen , ne largesi te Fshatrave kalivaç dhe Verri ne nje largesi te konsiderueshme nga qendrat e banuara.



Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky process do te kryhet sipas percaktimeve te Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "

Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pikes "7", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

Perfundimisht, per sa me siper, Në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të Ligjit Nr. 139, datë 17.12 2015 "Për veteqeverisjen vendore", i ndryshuar, citohet se: "***Këshilli bashkiak, ndër të tjera, e miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve***".

Duke pasur besim te plote, ju ftojme te miratoni projekt vendimin e paraqitur.

Ju Faleminderit !

Ju faleminderit!

Konceptoi: Kristjan MENKSHI

Arben BRAHO

Konfirmoi: Nexhmi

TORRA

Miratoi: Dritan

BABASULLI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 1288 Prot

Pogradec, më 19 03 2026

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA , PËR VENDOSJEN E ANTENAVE TË TELEFONISË TË LËVIZSHME NË FAVOR TË KOMPANIVE ONE ALBANIA SH.A NË SIPËRFAQE 160 M2 NË PASURINË 665 ZK 2042 KALIVAC, TREBINJË DHE VODAFON ALBANIA SH.A SIPËRFAQEN 100 M2 NË PASURINË 213/6 ZK 3753 VËRRI - PROPTISHT ”

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.” Po kështu në zbatim të nenit 54, shkronja “e” e po këtij ligji citohet se: “Këshilli bashkiak, ndër të tjera, miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve”.

Në këtë kuadër, Këshilli Bashkiak ka kompetencë të vendosë për mënyrën e përdorimit të pasurive publike dhe për dhënien e tyre me qira për qëllime të ndryshme ekonomike apo publike.

Projekt- vendimi parashikon miratimin e dhënies me qira të sipërfaqeve të caktuara të pasurive publike në administrim të Bashkisë Pogradec, për vendosjen e antenave të telefonisë të lëvizshme. Në këtë kuadër, Kompanitë ONE ALBANIA dhe VODAFONE ALBANIA kanë paraqitur kërkesë për përdorimin e sipërfaqeve të caktuara të pasurive publike për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike. Sipërfaqet objekt i projekt-vendimit ndodhen në territorin e Bashkisë



Pogradec dhe janë pjesë e pasurive publike të administruara nga kjo njësi e vetqeverisjes vendore.

Bazuar në Ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

"*Akt normativ nënligjor*" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Ky projekt-vendim nuk ka karakter normativ, pasi nuk vendos rregulla të përgjithshme dhe abstrakte për një numër të pacaktuar subjektësh, por trajton marrëdhënie konkrete juridike ndërmjet bashkisë dhe subjekteve përkatëse.

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedurave Administrative jep kete perkufizim për "Aktin administrativ":

a) "*Akti administrativ individual*" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektësh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) "*Akti administrativ kolektiv*" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektësh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Në rastin e këtij projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 1 "b", të Ligjit 44/2015 të "Kodi i Procedurës Administrative", pra përbën një akt administrativ kolektiv me disa përfitues të përcaktuar, pasi i drejtohet subjekteve të identifikuar konkretisht dhe lidhet me përdorimin e pasurive të caktuara publike.

Miratimi i këtij projekt-vendimi krijon mundësinë për përdorimin e ligjshëm të sipërfaqeve të kërkuara nga operatorët e telefonisë së lëvishme, duke kontribuar njëkohësisht në përmirësimin e mbulimit me shërbime elektronike në territorin e Bashkisë Pogradec dhe në gjenerimin e të ardhurave për buxhetin vendor.

Perfundimisht konkludojmë se: Projekt-vendimi paraqitet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë, sipas ligjit. Propozojmë degjesë publike me banorët e zonës dhe grupet e interesit.

Konceptoi: N. NAUN

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI

529
28.01.2026



Tiranë më, 26 Janar 2026

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Bashkia Pogradec
Adresa: Pogradec, Shqipëri

Per dijeni: Znj. Manjola Kamolli, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
Z. Ilia Xhakolli, Kryetar i Bashkisë.

Ref jonë: ND/L007/DQ
Kontakt: info-vfnd@vodafone.com

Lënda: Kërkesë për marrje sipërfaqe në përdorim te fondit pyjor.

Të nderuar/a Zonja, Zotërinj,

Shoqëria Vodafone Albania Sh.A ushtron aktivitetin e saj për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike në përputhje me Ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në përputhje me "Autorizimin Individual të Operatorëve të Telefonisë së Lëvizshme GSM" (Licensa), të lëshuar me Vendim Nr. 533, date 16.12.2008, nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike me brez të gjerë.

Vodafone Albania ka në plan të ndërtojë një stacion (antenë) bazë transmetimi në Njësinë Administrative Poptisht, në fshatin Verri, në pronë shtetërore (të dhënat e ASIG). Qendra e stacionit është në koordinatat **KRGJSH N-4541358.412 E-542156.363 H-679 m** dhe koordinata Gjeografike **"N-41°0'21.5" dhe E-20°30'3.8"**. Ky stacion është emërtuar **"1531 VERRI"**.

Kjo antenë ka një rëndësi të vecantë, jo vetëm për mbulimin me sinjal telefonik të fshatrave Poptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Verri, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore dhe fshatrave përreth, por edhe mbulimin e rrugës së re nacionale Qukës-Qafë Plloc.

Per sa më sipër cituar dhe bazuar në Udhëzimin nr. 1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullor publik", i drejtohem i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec me këtë kërkesë me anë të cilës, kërkojmë; marrjen në përdorim për një afat **9 -vjeçar** të sipërfaqes prej **100 m2** për ndërtimin e stacionit Vodafone_1531 VERRI , **68 ml** për hapjen e rrugës së re ndihmëse si dhe **937 ml** për implementimin e linjës elektrike TM të nevojshme. Vendi ku



është menduar të instalohet antena dhe rruga e re është në pronen me nr.213/6 zona kadastrale 3753 në fashin Verrë, Njësia administrative Proptisht, Bashkia Pogradec. Ndërsa Linja do të ndjek rrugën e fshatit Verrë -Slatinë) nga pika e lidhjes deri tek antena.

Bashkëngjitur kësaj kërkesë do të gjeni dokumentacionin përkatës të pregatitur nga Shoqëria nënkontraktore Intacom telecom Albania.

1. Kopje të ekstraktit QKB të subjektit;
2. Plani topografik i sipërfaqes së kërkuar në shkallën 1:10000;
3. Pamje e antenes;
4. Planimetri të antenes;
5. Gjurma dhe projekti i Linjës elektrike;
6. Projekti i rrugës.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj, mbetemi në pritje të miratimit Tuaj dhe të vazhdimit të procedurës për lidhjen e kontratës.

Me respekt,



VODAFONE ALBANIA SH.A.
Autostrada Tirane - Durrës
Rruga "Pavaresia", Nr.61
KASHAR, TIRANË
Kontakt: Tel: +355 4 22 63 332
Fax: +355 4 22 63 333
Menaxhër i Ndërtimit të Rrjetit
Vodafone Albania Sh.A.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VODAFON ALBANIA

RAPORTI TEKNIK

“PROJEKTIMI I RRUGESE SE RE VODAFONE
SITE VERRI-1531”

Firma konsulente

GeoPower sh.p.k

GEOPOWER
SURVEYING STUDIES AND PROJECTIONS






PËRMBAJTJA E RELACIONIT

1. – TË PËRGJITHSHME
2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT
3. – SPECIFIKIMET TEKNIKE
4. – VOLUMET E PUNIMEVE



1. – TË PËRGJITHSHME

Zona ne te cilen zhvillohet ky projekt eshte zona e Pogradecit, ne lindje te Shqiperise. Shtrihet me nje pozicion me gjeresi gjeografike $\varphi = 41^{\circ}00'21.5299''$ dhe gjatesi gjeografike $\lambda = 20^{\circ}30'03.9582''$ dhe me nje lartesi mesatare shtrirje rreth 679m mbi nivelin e detit.



Eshte nje zone me terren malor me bimesi mesatare. Klima eshte malore me dimer jo te ftohte dhe me vere te fresket me nje rrjet hidrologjik te zhvilluar.





Faktore te cilet japin nje ndikim ne projektimin dhe zbatimin e ketij aksi te ri rrugor. Behet fjele per nje objekt me shtrirje planimetrike relativisht te shkurter prej rreth 68 m. Fillimet e saj i ka ne lidhjen me nje rruge egzistuese dhe perfundon deri te antena. Zona ne afersi te rruges nuk eshte e populluar.

2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Kjo rruge parashikohet të jetë nje rrugë kryesisht ne sherbim te realizimit dhe mirembajtjes se antenes;

Gjate gjithë gjatesise se rruges terreni nuk eshte i pjerret. Punime per realizimin e ketij projekti do te realizohen ne funksion te terrenit, formes dhe parametrave gjeometrik te rruges.

Zgjidhja e projektit nga ana planimetrike dhe naltimetrike eshte realizuar duke u bazuar ne rendesine per kalueshmeri te plote ne cdo stine te vitit per tek Antena.

Gjeresia te trupit te rruges 4 m, e cila do perbehet prej pjesës kaluese me gjeresi 3m dhe me nje kanal anesor dheu 1.0 m ne krahun e siperm te germimeve ne seksionin terrthor me qellim pritjen dhe largimin e ujrave te shiut.

Profilimi I rruges ne seksion do te realizohet ne baze te germimit dhe mbushjes, ne funksion te formacionit gjeologjik te trasese ne te cilen do te ndertohet ruga dhe me qellimin e ritjes se qendrueshmerise se rruges duke patur parasysh garantimin edhe te parametrave ambiental. Para se te filloje ndertimi i paketes se shtresave rrugore do behet;

-Germimi ne forme kasonete per heqjen e shtreses vegetale ne gjithë gjeresine e rruges dhe konfigurimin e seksionit terthore dhe gjatesor te rruges.

-Cilindrimi i kasonetes.

-Mbi siperfaqen e realizuar nga procesi I profilimit germim-mbushje do te behet shtresezimi I rruges me dy shtresa; cakulli 2 dhe cakulli 1 me trashesi respektive 10cm dhe 5cm.





Aksi I ri do te filloj me progresiven 0.000 ne lidhjen me rrugen egzistuese dhe do te kete nje zhvillim planimetrik me disa vertekse kryesore deri ne sheshin ku mendohet te ndertohet antenna Vodafone me progresive perfundimtare 0+68 m. Ne drejtim te niveletes per llojin dhe ngarkesen e parashikuar te trafikut eshte realizuar nje nivelet me pjerrresi jo me shume se 16.10% gjate gjithë zhvillimit te rruges.

3. – SPECIFIKIMET TEKNIKE

Projekti eshte realizuar bazuar ne matjet topografike ne terren me pajisje Instrumentale Gjeodezike Dicitale. Eshte perdorur sistemi satelitor i pozicionimit TopCon GR-3 dhe instrumenti Total Station TopCon IS 203. Matjet dhe perftimi i materialit topografik eshte realizuar bazuar ne keto parametra kryesor saktësie:

Statike (3mm+5ppm horizontal, 5mm+5ppm vertical).

RTK / Kinematik (10mm+1ppm horizontal, 15mm+1ppm vertikale).

Pozicioni reciprok ndermjet 2 pikave poligonale jepet ne baze te: $t=0.1 \times L(\text{km})\text{m}$

Gabimi gjatesor ne poligonometrine e perftuar eshte:

$$TL = (0.05\sqrt{L} + 0.05 \times L + 0.4) \text{ m,}$$

ku L=gjatesia e poligonot ne km

Ky gabim i shprehur ne gabime gjatesore dhe terthore do te jete si me poshte:

$$FL = \pm (0.03\sqrt{n} + 0.01n + 0.10)$$

$$FQ = \pm (m\beta L \sqrt{n/12} + 0.10)$$

Ku: n = numri i kendeve horizontale

L = gjatesia e poligonit ne km

mβ = gabimi i matjes se kendeve horizontal

Saktësia ne percaktimin e kuotave ndermjet pikave poligonale eshte percaktuar si me poshte:

$$FH = \pm (M \text{ 1km } \sqrt{L} + 0.03)$$

Ne perfundim eshte perftuar nje material topografik dicital ne Sistemin Koordinativ UTM Zone 34N, ne formatin dwg. Mbi keto baza eshte realizuar dhe projekti i rruges ne studim.

Projekti eshte realizuar si ne plane dhe ne lartesi bazuar ne keto element gjeometrit:

$$T = R \cdot \text{tgr } \varphi/2$$

$$B = R \cdot (\text{sec } \varphi/2 - 1)$$



$$K = \frac{R \cdot \varphi}{\rho}$$

Projekti gjithashtu është realizuar nga ana gjeometrike bazuar dhe në seksionin tip të paraqitur në këtë relacion.

4. – VOLUMET E PUNIMEVE.

Shih tabelat përkatëse.

Progr esivi	Seksi onet	Sip.Mb ushje	Sip.Ger mim	Vol.Mb ushje	Vol.Ger mim	Vol.Prog.M bushje	Vol.Prog.G ermim
0+000. 00	Sc-1	0,01	0,54	0	0	0	0
0+010. 00	Sc-2	0	1,02	0,04	7,8	0,04	7,8
0+020. 00	Sc-3	0,02	1,13	0,13	10,59	0,17	18,39
0+030. 00	Sc-4	0,24	0,3	1,35	7,13	1,52	25,52
0+040. 00	Sc-5	0,38	0,38	3,1	3,38	4,62	28,9
0+050. 00	Sc-6	0	0,76	1,9	5,69	6,52	34,59
0+060. 00	Sc-7	0,01	1,92	0,06	13,46	6,58	48,05
0+067. 93	Sc-8	0,01	0,47	0,08	9,45	6,66	57,5

Në tabelën më sipër jepen sipërfaqet në m² dhe vëllimet në m³ për çdo progresive dhe në total për gjithë gjatësinë e rrugës.



Intracom Telecom Albania S.A.

Relacion Teknik

Projektoi

Ing. Albion GERRI A. E:1875/1



Porositi

VODAFONE ALBANIA Sh.A.



Relacioni Teknik

Objekti: Furnizimi me energji elektrike i stacionit Verri (1531).

Projekti teknik është hartuar me qëllim që:

1. Të realizojë furnizimin me energji elektrike të stacionit Verri (1531) në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) të miratuara me vendim të Bordit të Komisionerëve Nr. 22 Dt. 25.02.2012.
2. Të respektojë të gjithë legjislacionin në fuqi, veçanërisht parimet e mbrojtjes së sigurimit teknik dhe sigurisë në punë të instalimeve elektrike për të garantuar që shtesa e kryer në rrjetin e shpërndarjes të jetë në gjendje të shfrytëzohet dhe mirëmbahet në mënyrë të sigurtë dhe efektive.
3. Të marrë në konsideratë mundësinë e hyrjes në ambient pa problem si dhe përjashtimin e faktorëve që lidhen me zhurmat dhe rrezikun nga përmbytjet në përputhje me standardet në fuqi.
4. Pajisjet që do të realizojnë lidhjen për furnizimin me energji elektrike duhet të jenë të reja dhe parametrat nominalë të tyre (përcjellesat, kabllot, transformatori, çelat e Tensionit të Mesëm (TM), panelet e Tensionit të Ulët (TU), matësi i konsumit të energjisë elektrike, etj.) duhet të jenë në përputhje me tipin dhe kërkesat teknike të përshkruara sipas standardeve të kërkuara nga:
 - a) Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha)
 - b) Dispozitat shtetërore në fuqi
 - c) Standardet ndërkombëtare IEC
5. Tokëzimi i kabinës së transformatorit apo i pikës së lidhjes në TU të jetë konform legjislacionit në fuqi dhe rezistenca ohmike e saj të jetë konform rregullave të sigurimit teknik, më e vogël se $< 4\Omega$.
6. Mbrojtja të synojë tre drejtime kryesore, nga të cilat përcaktohet konceptimi i tyre:
 - a) Mënjanimi ose të paktën kufizimi i dëmtimeve në elementët e skemës principale elektrike. Këto dëmtime, që çojnë në regjim jo-normal pune shkaktohen kryesisht nga:
 - i. Prishja e izolacionit midis fazave ose me tokën, gjë që çon në lidhje të shkurtër (LSH)
 - ii. Këputja e fazave
 - iii. Prishja e izolacionit e cila mund të vijë si pasojë e mbritensioneve që mund të jenë të brendëshme ose të jashtme (psh. goditje rrufeje etj.)
 - iv. Rrymat e mëdha që shfaqen gjatë lidhjes së shkurtër LSH dhe sjellin veprime termike dhe dinamike me pasoja shkatërrimin e materialeve
 - b) Kufizimin dhe veçanërisht minimizimin e ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike të stacionit të telefonisë celulare.



- c) Mënjanimi me çdo mjet të mundshëm për krijimin e situatave të rrezikshme për jetën e njerëzve dhe pasurinë (si zjarre etj.)

Duke qenë se linja e furnizimit me energji elektrike është radiale, janë përdorur skema dhe mjete të thjeshta mbrojtëse nga mbirrymat, të kombinuara me shkallëzime të përshtatshme. Zona e veprimit të mbrojtjeve, që në skemë janë me simbolikën përkatëse (shiko legjendën), është si vijon:

- Ato të linjave të TU dhe TM
- Të instalimeve të brendshme elektrike

Te dhenat teknike të linjes së TM së furnizimit me energji elektrike të stacionit

Furnizimi me energji elektrike i stacionit Verri (1531) të Vodafone Albania shpesh do të bëhet nga rrjeti elektrik ekzistues i tensionit të mesëm (TM) të OSHEE-së 10/6 kV që furnizon kabinën ekzistuese të fshatit Verri.

Kjo linje elektrike e TM, do të shërbejë për furnizimin e stacionit ekzistues të telefonisë, dhe ka keto te dhena si më poshtë:

- Gjatesia e linjes nga pika e lidhjes deri në stacion do të jetë 937 m.
- Trasheja e saj do të kalojë anës rruges që shkon në stacionin e ri që do të ndërtohet, duke ndjekur gjurmen e rruges dhe pa demtuar bimesinë në të gjithë gjatësinë e këtij segmenti.
- Linja do të ndërtohet ajrore me shtylla betoni centrifugale b/a H= 9m (6KN) ndërsa shtyllat mbështetëse do të jenë b/a H= 8m (6KN). Modeli i shtyllave të betonit (centrifugale) është i bazuar në manualin specifikimeve teknike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSHEE, që i bashkëngjitet këtij Relacioni Teknik.
Gropat e shtyllave do të jenë me thellësi 1.5 meter dhe do të forcohen me materialet e nevojshme për të krijuar një bazament të qëndrueshëm dhe të jenë të mbrojtura nga faktorët dhe kushtet atmosferike.
Shtyllat do të vendosen në një distancë 35-40m larg nga njëra tjetra për dy arsye:
1) Terreni është i thyer dhe në atë lartësi fryn shumë ertë.
2) Reshjet e dendura që bien në zonë.
Neqoftese nuk respektohen këto distanca rrezikohet demtimi i shtyllave.
Numri i shtyllave është llogaritur të jetë sa më i vogël në mënyrë që të mos ketë impakt në peisazhin e zonës. Gjithashtu është llogaritur me përpikëri edhe distanca optimale për të qenë brenda kushteve teknike. (rrezikohet lidhja e shkurter nëq shtyllat janë më larg se 40 meter nga njëra-tjetra)
- Përcjellesi do të jetë AL-Ç Ø 25mm², Tel alumini me seksion 25mm me fije çeliku në mes dhe i ngjashëm me linjat e OSHEE. Praktikisht është i pamundur demtimi apo keputja e Telit nga faktorët e jashtëm.
- Tranversat do të jenë të tipit "Kokore" me tek izolator dhe doplo në rastet kur kampata kalon mbi rrugë.
- Sistemi i tokezimit do të realizohet me elektroda tokezimi 1.5m (standarte) dhe lidhja në konturit do të bëhet me përcjelles të zveshur bakri Cu 35 mm². Të gjitha pjesët metalike e kabines do të lidhen me konturin e tokezimit si dhe do të tokezojnë neutri i transformatorit.
- Ndaresi i linjes është 3Fazor 10kv, 200A për përdorim të jashtëm dhe vendoset në fillim të linjes. Kjo bëhet që nëq linja ka defekte të bëhet heqja e Tensionit dhe të bëhen riparimet në linjë.
- Shkarkuesit e linjes vendosen pas ndaresit të linjes dhe lidhen me tokezimin. Shkarkuesat janë të tipit Polimer.
- Siguresat janë të tipit 10kv për përdorim të jashtëm me I_{max} 16A në filament.



- Transformatori do të jetë 50kva (10/04kv) me vaj, i montuar në një bazament metalikë i montuar në shtyllë betoni 9/8
- Dalja e TU nga bornat e TR deri te Automati 3P 32 A ,behet me kabell bakri Cu 4x25mm²

Matja e konsumit të energjisë elektrike

Për matjen e energjisë duhet të plotësohen të gjitha rregullat në fuqi nga OSHEE sha (Operatori i Shpërndarjes Energjisë Elektrike). Matësi i energjisë elektrike do të montohet në një pozicion të caktuar në objekt dhe do të jetë pronë e OSHEE sha. Matesi i energjisë elektrike mund të jetë 3 Fazor me fuqi të kërkuar Pk= 20 KW dhe Limitator 40A .Nqs do të shtohet sasia e paisjeve të instaluara atehere rrjedhimisht do të ndryshojë dhe fuqia e kërkuar në OSHEE sha për të ndryshuar limitatorin. Matësi do të jetë objekt i leximit nga punonjësit e OSHEE-së, të cilët do të bëjnë vlerësimin e konsumit sipas regjistrimeve të tij. Te gjitha të dhënat e matesit të enegjise elektrike si nr. serise, lloji i limitatorit,vula e morsetesirë, vulat e jashme janë të shënuara në kontratën e furnizimit të OSHEE

Tokëzimi mbrojtës.

Sipas dispozitave në fuqi në vendin tonë, të gjitha rrejet elektrike të TU të OSHEE-së ndërtohen me neuter të tokëzuar, vlera e matur e të cilit në kohë të thatë apo me ngricë duhet të jetë brenda normave të lejuara dhe më konkretisht të jetë më e vogël se < 4Ω. Për këtë do të mbahet një protokoll tip i miratuar nga IQT. Në rastin tonë, kur në pikën e lidhjen së propozuar nga OSHEE nuk është vlera e rekomanduar, atëherë do të merren masa për uljen e saj duke përdorur elektroda tokëzimi shtesë, referuar skemës së tokëzimit bashkëlidhur këtij relacioni. Qëllimi i këtij tokëzimi shtesë është ulja e tensionit të hapit si dhe tensionit të prekjes së pjesëve metalike në vlera të parrezikshme për jetën e njeriut, në rast të dëmtimit të izolimit të paisjeve.

ELEKTRODAT E TOKËZIMIT

Si tokëzues do të përdoren elektroda prej hekuri të zinkuar me gjatësi nga 1.5m deri në 2.0m, në formë "X" ose "L", të cilat do të ngulen në tokë gjatë një kanali me thellësi 0.7m. Si përcjellës tokëzimi do të përdoret përcjellës Cu me seksion 35mm². Në raste specifike mund të përdoret hekur i rrumbullakët i zinkuar me dimension $\phi = 10\text{mm}$ ose shirit i zinkuar me dimension 30x3mm. Përcjellësit mbrojtës merren të veshur me ngjyrë të verdhë-jeshile, ndërsa përcjellësit e tokëzimit merren të zhveshur prej bakri.

-Te dhënat teknike te elektrodës

Formë kryqi "+" jo më pak se 50x5mm, H=1.5 ose 2.0m, që nuk shtrihet/zgjatet
Cilësia e çelikut DIN 17 100
Pajisur me pllakë bashkuese
Paisur me morseten për bashkimin me përcjellësin me diameter deri 13mm
I përputhshëm me DIN 48 – 452
Shtresë zinku – minimumi 70 mikron.



-Morseta

Morseta është e përbërë prej materiali me një qëndrueshmëri shumë të lartë i cili është veshur me një shtresë anti korrozive zinku me një trashësi 60 mikron. Morseta shtrengohet fort me bulona të cilat kanë një shtresë anti korrozive. Bullonat dhe rrodet janë prej çeliku të galvanizuar në të nxehtë.

-Fiksues për përcjellësin e tokësimit në faqe të murit ose beton

Sherben për fiksimin e përcjellësit të tokësimit të rumbullakët në faqe të murit ose beton. Diametri maksimal i përcjellësit që fiksohet është \varnothing 8-12mm. Bullonat shtrengues janë M6x16mm. Në pjesën e fiksimit, fiksuesi ka dado me fileto M8 mm, e përshtatshme për montim në up plastik universal me vidë me koke me fileto metrike. Pjastrat fiksues kanë spesor 3 mm. Të gjitha materialet janë çelik të galvanizuar në të nxehtë.

-Fasheta Plastike PVC

Temperatura e punës: - 40°C deri + 80°C

Rezistenca ndaj zjarrit 650 °C

Rezistente ndaj kimikateve, vajrave, lubrifikanteve, yndymave, alkolit

Me buze të rumbullakosura për të parandaluar dëmtimin e përcjellësit

Rezistent ndaj rrezatimit UV

Ngjyra : e zezë, e bardhë, ose sipas kërkesës

-Fashetat vetbllokuese prej çeliku për fiksimin e mbrojtëse

Fashetat vetbllokuese prej çeliku 0.25x12x1200mm, për fiksimin e mbrojtëses në shtyllë duhet:

Të ketë një mekanizëm vetbllokues që lejon përdorim të lehtë dhe të shpejtë,

Qëndrueshmëri të lartë në tërheqje, Elasticitet të lartë, Të jetë zjarrdurues,

Të ketë qëndrueshmëri të lartë ndaj agjentëve atmosferikë, korrozionit si dhe acideve dhe bazave të ndryshme.

Materiali: çelik inoksitabel # 316

Fashetat vetbllokuese prej çeliku për fiksimin e mbrojtëses në shtyllë duhet të sigurojë

Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike (LPS)

Sistemi mbrojtës LPS (lightning protection system) i cili do të ndërtohet jashtë objektit, përbëhet nga tërësia e elementëve që shërbejnë për mbrojtjen e objektit nga goditjet e rufeve. Projekti teknik për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike për objektin duhet realizuar sipas normës EN 61024-1 dhe sipas normativave të shtetit shqiptar. Materialet për ndërtimin e këtij impianti duhet të përmbushin standardin e sipërpërmendur EN 61024-1.

Ky sistem është projektuar që të mbrojë nga dëmtimet e rufeve të cilat vijnë në disa rrugë:

- Nga shkarkimi direkt në banesë apo objekt
- Nga shkarkim indirekt (shkarkimi në tokë pranë banesës apo objektit)
- Nga shkarkim i rufesë në linjën që hyn në banesë apo objekt
- Nga shkarkim i rufesë në tokë pranë linjës që hyn në banesë apo objekt



Sistemi LPS është projektuar të realizohet sipas normave ndërkombëtare për objektin e klasit të I-rë, ku hyjnë objektet ku goditja e rrufesë mund të shkaktojë humbje të jetëve njerëzore dhe me efikasitet maksimal 0.98.

Si rregull tokëzimi i konstruksionit të antenës dhe pajisjeve duhet bërë i veçantë. Tokëzimi i tyre do të kryhet sipas kushtit teknik të sistemit triangle. Si tokëzues do të përdoren elektroda prej hekuri të zinkuar me gjatësi nga 1.5m deri në 2.1m, në formë "X" ose "L", të cilat do të ngulen në tokë gjatë një kanali me thellësi 0.7m. Si përcjellës tokëzimi do të përdoret përcjellës Cu me seksion 50mm². Në raste specifike mund të përdoret hekur i rrumbullakët i zinkuar me dimension $\phi = 10\text{mm}$ ose shirit i zinkuar me dimension 30x3mm. Vlera e tokëzimit duhet të jetë më e vogël se $< 4\Omega$.

Nga konturet e tokëzimit bëhet ngjitja me përcjellësa të veçantë. Në rastin e pajisjeve, ngjitja bëhet më përcjellës të veshur me ngjyrë të verdhë-jeshile me seksion 50mm² duke e futur në kolonën e pallatit dhe duke e fiksuar çdo 1m. Në rastin e antenës ngjitja do të kryhet me përcjellës St/Zn me $d=10\text{mm}$ i cili do të kapet me konturet përkatëse të tokëzimit të antenës dhe të pajisjeve.

Të gjitha pjesët e impiantit mbrojtës nga rrufetë nga shkakrimet atmosferike duhet të jenë të dukshme, me përjashtim të elektrodave të tokëzimit dhe shiritit që i bashkon ato në formë konturi të mbyllur. Konturi i tokëzimit mbrojtës nga rrufetë dhe tokëzimit mbrojtës duhet të jenë me konture të veçanta për të evituar rrezikun e kthimit të valëve të fuqishme të rrymës së rrufeve mbrapsht tek pajisjet nëpërmjet tokëzimit. Rezistenca e tokëzimit të impiantit të rrufepritëseve e matur në kushtet më të disfavorshme (në motin më të thatë në verë dhe në motin më me ngrica në dimër) duhet të jetë më e vogël se 2Ω .

Impianti mbrojtës nga shkarkimet atmosferike është parashikuar të realizohet me shufër hekuri të zinkuar në të ngrohtë me diameter 10mm dhe çdo bashkim do të bëhet me morsetë zinkato.

Instalimet elektrike

Bokset outdoor janë të pajisura me një bord të shpërndarjes elektrike PM Board, prodhuar sipas specifikave të vizatimit bashkëlidhur të skemës elektrike të stacionit dhe me shkallë mbrojtje IP 55 – IP 65 (referuar standardeve të paraqitura më poshtë).

- Kabllot 1.5mm² janë përdorur për ndriçimin
- Kabllot 2.5mm² janë përdorur për furnizimin me energji elektrike (prizë për përdorim të jashtëm IP 55)
- Kabllot janë 5x10 mm²

Kabllot i furnizimit me energji elektrike për stacionin do të jetë 5x10mm² ose 5x16mm². Ai do të jetë i montuar në kanalina metalike të elektro-galvanizuara në përputhje me standardin IEC 7-6 dhe BS 729, e cila do të kalojë nëpër rrugët e pershtatshme.

Jashtë bokseve outdoor dhe pranë boksit TU është parashikuar në mënyrë alternative instalimi i një paneli elektrik me përmasa 550x650x300 mm IP 65, për furnizimin nga jashtë të stacionit në rastet e avarive dhe të mungesës së energjisë nga OSHEE, duke montuar një çelës me tre pozicione 1-0-2 me rrymë 80A si dhe një prizë për përdorim të jashtëm IP 65 me 3F+1T+1N me rryme 63A i



papërshkueshëm nga uji, plug 5-pol (5x63A). Përdorimi i këtij paneli alternativ do të lehtësojë lidhjen elektrike mes gjeneratorit portativ jashtë dhe BTS-së.

Standardet e kablllove të TU

1. Të dhëna të përgjithshme

Këto specifikime mbulojnë kërkesat e kablllove nëntokësore të rrymës dhe tensionit të ulët që do të përdoren për furnizimin e stacioneve të telefonisë celulare. Të gjithë kabllo të nëntokësorë të rrymës janë projektuar për të garantuar eficiencë në kushtet atmosferike të detajuara në vijim, pa dëmtime apo përkeqësime gjatë veprimit të mbitensioneve në ndonjë pjesë. Kabllo të nëntokësorë të energjisë janë përzgjedhur për të përmbushur çdo luhatje të ngarkesave elektrike, të tensioneve si dhe të lidhjes së shkurtër ose rrethanave të tjera që mund të shfaqen në sistem.

2. Kushtet klimaterike

- Temperatura maksimale e ajrit +50°C
- Temperatura mesatare maksimale ditore +40°C
- Temperatura minimale e ajrit -20°C
- Temperatura maksimale e diellit në sipërfaqet e ekspozuara horizontale +60°C
- Lagështia relative maksimale në tokë 95%
- Lagështia relative maksimale në ajër 80%
- Lartësia maksimale mbi nivelin e detit <2000m
- Ndotja Niveli (II) mesatar

3. Kushtet e sistemit të shpërndarjes

Specifikimet	Njësia	Sistemi 0.4kV
Tensioni i sistemit	kV	0.6/1
Frekuenca	Hz	50
Gjendja e neutrit (tokës)		1 tokëzuar
Fuqia e çkyçjes së LSH	kA	16

Kabllo janë në përputhje me standardin ndërkombëtar IEC 60502. Nuk lejohen kabllo të standardeve të tjera. Kabllo të nëntokësorë të tensionit të ulët duhet të jenë në përputhje me standardet e mëposhtme IEC:

- IEC 227 – Kablo me izolacion PVC dhe me tension deri në 450/750 V
- IEC 228 – Përcjellesit e kablllove të izoluar
- IEC 724 – Udhëzues për kufijnë e lejuar të temperaturave në lidhje të shkurtër të kablllove me një tension që nuk i kalon 0.6/1.0 kV
- IEC 754 – Testi për gazet që çlirohen gjatë djegies së kablllove elektrike
- IEC 811 – Metodat për testimin e materialeve izoluese dhe veshjes së jashtme të kablllove
- IEC 885 – Metoda e testeve elektrike për kabllo elektrike



Kabllo e TU duhet të jenë të aftë të punojnë në mënyrë të vazhdueshme deri në temperaturë maksimale jo më tepër se 60°C. Përcjellësit prej bakri duhet të jenë të shkallës së pastërtisë elektrike. Fazat duhet të identifikohen prej ngjyrave të ndryshme.

Panelet TU

Të dhënat teknike:

- Panelet do të përzgjidhen sipas IEC 61439-1 dhe 2
- Panelet duhet të përballojnë LSH 16kA/1sec
- Panelet duhet të jenë të prodhuara për rrymë nominale 160A me temperaturë pune -25°C deri në 60°C
- Panelet duhet të plotësojnë kërkesat në përputhje me performancën teknike dhe elektro-dinamike
- Panelet duhet të jenë jo të korodueshme, jo higroskopike me shkallë mbrojtje IP 65 dhe të pajisura me:
 - Aksesorët përkatës për montim të jashtëm
 - Aksesorët për instalimin e automateve
 - Aksesorët mbyllës
 - Aksesorët për komponentët e morseterisë (fazave, neutrit dhe tokëzimit mbrojtës, krehër ushqyes etj.)
- Panelet duhet të jenë të dizenuara për të krijuar mundësinë e lidhjes së kablove të TU. Hyrja e kablos së furnizimit duhet të bëhet në krahun e majtë dhe dalja në të djathtin.
- Testimi i paneleve do të kryhet sipas standardit IEC 60529

Mbrojtja nga mbirrymat dhe LSH

Mbrojtja nga mbirrymat dhe LSH do të realizohet me automat, funksionet kryesore të të cilës janë:

- Mbrojtje elektrike
- Izolim i sigurt nga pjesët me tension
- Komandim lokal dhe në distancë

Për instalimet do të përdoren automate në përputhje me standardin e përshtatshëm IEC 60947-2 ose një standard ekuivalent kombëtar (60947-1: Rregullat e Përgjithshme ose 60947-2: Pjesa 2: Qark-Shkëputësi)

Tensioni i shërbimit		230/400V
Numri i poleve		1P, 3P, 4P
Mbrojtja termo-magnetike	Mbingarkesa	$I_r = I_n$
	LSH	$I_m = 7I_n$
Rryma max e LSH		6kA, 10kA
Niveli i mbrojtjes	IP 20	IP 20
Temperatura e punës	-40°C...+80°C	-40°C...+80°C
Në zbatim të standardit IEC 60947		Kurba B dhe C



Në grupin me karakteristikë të tipit B futen ato automate të cilët veprojnë në çast për rryma më të mëdha se 5In. Këto do të përdoren për mbrojtjen e linjave dalëse. Në grupin me karakteristikë të tipit C futen automatet të cilët veprojnë në çast për rryma më të mëdha se 10In. Ato do të përdoren në linjën që furnizon pajisjet me elektromotorë me lëshim të vështirë.

Për selektivitet me automatët e linjave dalëse, automati kryesor i kuadrit kryesor është zgjedhur mbi bazën e fuqisë së kërkuar, me rrymë nominale më të madhe se ato të linjave dalëse dhe do të jetë i tipit C.

Mbrojtja nga mbitensionet

Mbitensionet e jashtme shkaktohen nga goditjet e rrufeve (mbitensione atmosferike), kurse ato të brendshme gjatë manovrimeve operative ose gjatë LSH. Duke qenëse mbitensionet atmosferike nga ato të brendshme janë shumë më të mëdha, izolacioni dhe mbrojtja e instalimit të stacionit janë të përcaktuara në bazë të mbitensioneve atmosferike.

Mbrojtja e instalimeve nga mbitensionet në parim tenton shmangien ose të paktën kufizimin e dendësisë së shfaqjes së tyre. Mbrojtja nga mbitensionet është projektuar me tendencën e minimizimit të pasojave, pavarësisht kostos së lartë që ato mund të kenë.

Për mbrojtjen nga mbitensionet do të përdoren shkarkuesat për të realizuar sigurinë e njerëzve, mbrojtjen e pajisjeve, vijmësinë e furnizimit me energji elektrike në një farë mase dhe izolimin, i cili synon reduktimin e mundësisë së dëmtimit të pajisjeve elektrike.

Këto komponentë do të shërbejnë për të mbrojtur, kufizuar ose eliminuar shkarkimet. Këto komponentë quhen shkarkuesë:

- Për mbrojtje nga mbitensionet me origjinë atmosferike ose ato të komutimit gjatë kyçjeve
- Për mbrojtje të panelit të shpërndarjes së TU

Mbrojtja e panelit BTS nga shkarkimet atmosferike

Në impiantin elektrik mund të vijnë mbitensione nga goditjet direkte të rrufesë në linjën furnizuese apo mund të induktohen mbitensione nga goditjet e rrufesë pranë linjave elektrike që e furnizojnë atë. Për të eliminuar këtë, në panelin kryesor të BTS instalohen kufizuesat tensioni ose shkarkuesë tensioni më rryma shkarkimi më të mëdha se 10kA për një valë 8/20µsek që lidhen ndërmjet përsjellesve të rrjetit dhe tokës me një përcjelles më të madh se 6mm². Për këtë përdoren varistore me oksid silici ose zinku me tension nominal 275V dhe tension mbetës 1000V.

Të dhënat teknike

Cod	68 44 146/147 (RC)	68 44 146/147 (RC)
Numri i fazave	1	1
Lidhja ndërmjet terminaleve	L-N	N-PE
Tensioni nominal i punës Un	230V, 50Hz	230V, 50Hz
Tensioni maksimal i punës Us	275V, 50Hz	275V, 50Hz
In "class II" test (8/20µs) 1P	15kA	20kA
Niveli i mbrojtjes	IP 20	IP 20

Temperature e punës
Në zbatim të EN 61643-11 & IEC 61643-1

-40°C...+80°C
T2, class II

-40°C...+80°C
T2, class II



Ndriçimi

Boksi ka një dritë emergjente me bateri back-up mbi derën e boksit conform standardit IEC 60598-2-22. Për kryerjen e punimeve riparuese Brenda boksit ka një ndriçues 100W dhe rizistent ndaj ujit. Njëkohësisht në stacion në majën e antenës do të ketë ndriçues me detektor për sinjalizmin në distance të aviacionit me IP 65.

Përgatiti dhe Relatoi

Ing. Albion GRRICA

Nr. Liçense E.1875/I



MEMO

NEW SITE ORDER

SITE NAME: MALINE
SITE CODE: 1838
GREATER AREA: EALB



A. Introduction

New site MALINE is located in national road Qukes – Qafe Plloce.

The purpose of this page is to cover a part of the new national road from Qukës to Qafë Pllocë, which is very frequented by people traveling from Tirana to Korçë. This road is part of the roads requested to be covered by AKEP (Electronic and Postal Communication Authority). So, for these reasons, we have concluded to add the new site MALINE.

Based on customer complaints and continuously increasing demand for high data rates we have decided to add a new site which will offer all technologies 2G, 3G & 4G.

We have concluded to build a new site MALINE, which will provide very good coverage.

B. Position of BTS

MALINE site will be placed in a dominant position which aims to cover this part of national road.





C. SITE TYPE AND EQUIPMENT INSTALLATION

- Civil Works

Site MALINE will comprise: 30 HEAVY MAST

- Radio Equipments

Radio equipment's will comprise Ericsson Outdoor BTS with a configuration 2+2+2 in GSM, 3+3+3 in 3G and 2+2+2 in 4G with antenna system with three sectors.

Directions of antennas will be:

- Cell A: 80° (2 m long radio antenna)
- Cell B: 125° (2 m long radio antenna)
- Cell A: 310° (2 m long radio antenna)



"SITE SURVEY REPORT"

GREAT AREA	EALB
SITE CODE	1838
SITE NAME	MALINE
PREFECTURE	KORCE



SITE INFORMATION (LANDPLOT)

SITE NAME	<input type="text" value="MALINE"/>	BSC	<input type="text"/>
SITE CODE	<input type="text" value="1838"/>		
PROPERTY	<input type="text" value="State"/>		
USE	<input type="text" value="Hill"/>		
ADDRESS STR.	<input type="text" value="Kalivac Village"/>		<input type="text"/>
AREA	<input type="text" value="EALB"/>	ZIP CODE	<input type="text"/>
PHONE No	<input type="text"/>		
INFORMATION FROM	<input type="text"/>		
LONGITUDE	<input type="text" value="20°36'19.93''"/>	LATITUDE	<input type="text" value="40°51'58.95''"/>
ELEVATION	<input type="text" value="1326 m"/>		
DISTANCE FROM CLOSEST CITY	<input type="text"/>		
DISTANCE FROM MAIN ROAD	<input type="text"/>		
ROAD CONSTRUCTION REQUIREMENT	<input type="text" value="YES"/>		
REQUIRED LENGTH	<input type="text" value="160 m"/>		
ACCESS ROAD	ASPHALT <input type="checkbox"/>	SOIL	<input checked="" type="checkbox"/> X <input type="checkbox"/> MAD <input type="checkbox"/>
ROAD CONDITION	GOOD <input type="checkbox"/>	MEDIUM	<input checked="" type="checkbox"/> X <input type="checkbox"/> BAD <input type="checkbox"/>

VISIBILITY DESCRIPTION

<p>70° TUSHEMISHT</p> <p>144° GRUNJAS</p>

ADDITIONAL SITE INFORMATION



SITE NAME

BSC

POWER SUPPLY 220 V ac NO

48 V dc

DISTANCE FROM CLOSEST
PPC NETWORK (km)

MEDIUM VOLTAGE:
LOW VOLTAGE:

AVAILABLE CO/C

F/O

M/L

PROPOSED INTERCONNECTION

EXISTING MAST NO

HEIGHT

ROOFTOP
GROUND

MAST CONSTRUCTION
REQUIREMENT YES

MAST HEIGHT ON ROOFTOP
MAST HEIGHT ON GROUND

MAST BASE AVAILABILITY

MAST DETAILS

MAST LOCATION

ESTIMATED CABLE LENGTH (m)

AVAILABLE
NON-COVERED
SPACE

ADJACENT HIGH VOLTAGE
TRANSMISSION LINES

NEARBY
OBSTRUCTIONS

ORIENTATION MAP YES

PHOTOGRAPHS YES PHOTOGRAPH CODE

REMARKS:


CELL A: 80°

CELL B: 125°

CELL C: 310°

SURVEY TEAM:
SURVEY DATE:

ORIENTATION PHOTO





UTM KORDINATE

X=466765
Y=4523925


Legend
Antena One

Antena One

Google Earth

© 2005 Airbus
© 2006 CNES / Airbus

100 m



UTM KORDINATE

X=458041.72
Y=4539539.91

Legend

Antona vodofone

